

Gjuha boshnjake

Gjuha Boshnjake ose **Bosnjane**, (Anglisht: *Bosnian language*, *Bos*: *Bosanski jezik*) është gjuhë indoevropiane dhe i takon familjes së gjuhëve sllave.

Përmbajtja

Kundërthëniet

Alfabeti

Referimet

Shiko dhe këtë

Kundërthëniet

Emri "gjuha bosnjane" (Anglisht: *Bosnian language*, *Bos*: *Bosanski jezik*) është një çështje e debatueshme për disa kroatë dhe serbë, të cilët gjithashtu i referohen asaj si gjuha "boshnjake" (serbo-kroatisht: bošnjački / бошњачки). Megjithatë, gjuhëtarët boshnjakë këmbëngulin se emri i vetëm legjitim është gjuha bosnjane (bosanski, bosnian), dhe se ky është emri që duhet të përdorin edhe kroatët e serbët. Polemika vazhdon sepse emri "bosnjan" mund të duket se nënkupton që është gjuha e të gjithë boshnjakëve, ndërkohë që kroatët dhe serbët boshnjakë e kundërshtojnë atë caktim për idiomat e tyre. Sipas Marrëveshjes së Dejtonit 1995 gjuha zyrtare quhet "gjuha bosnjane" (Bos:Bosanski jezik, Anglisht: *Bosnian language*).^[1] dhe si e tillë është konstatuar edhe nga vëzhguesit që kanë marrë legjitimitetin dhe njohjen ndërkombëtare në atë kohë.^[2]

Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO),^[3] Bordi i Shteteve të Bashkuara për Emrat Gjeografik - United States Board on Geographic Names (BGN) dhe Komiteti i Përhershëm për Emrat Gjeografik - Permanent Committee on Geographical Names (PCGN) e njohin gjuhën bosnjane. Për më tepër, statusi i gjuhës bosnjane njihet edhe nga organizma të tillë si United Nations, UNESCO, si dhe agjencitë e përkthimeve dhe interpretimeve,^[4] duke përfshirë edhe shërbimin e përkthimeve në internet.

Shumica e enciklopedive të gjuhës angleze (Routledge, Glottolog,^[5] Ethnologue,^[6] etj. ^[7] e regjistrojnë gjuhën vetëm si gjuhë "bosnjane". Biblioteka e Kongresit e regjistroi gjuhën si "Bosnjane" dhe i dha asaj një numër ISO. Institutet e gjuhës sllave në shtetet anglishtfolëse ofrojnë kurse vetëm në gjuhën "bosnjane" ose "bosnjane / kroate / serbe", e jo në gjuhën "boshnjake" (p.sh. Columbia,^[8] Cornell,^[9] Chicago,^[10] Washington,^[11] Kansas^[12]). E njëjta gjë ndodh në vendet gjermanofone, ku gjuha mësohet nën emrin *Bosnisch* dhe jo *boshnjakisht* (p.sh. Vjenë,^[13] Graz,^[14] Trier^[15] etj.).

Alfabeti

Gjuha boshnjake

Flitët në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Serbi, Mal të Zi, Kroaci, Turqi

Vendi Evropa juglindore

Folësit

Përgjithshëm 3 milion

Taksonomia

Filogjeneza Gjuhët indo-evropiane

 Gjuhët sllave

 Gjuhët sllave jugore

Statusi zyrtar

Zyrtare në Bosnjë dhe Hercegovinë

Minoritare në Kosovë, Serbi, Mal të Zi, Kroaci

Kodet e klasifikimit

ISO 639-1 bs

ISO 639-2 bos

Marrë nga "https://sq.wikipedia.org/w/index.php?title=Gjuha_boshnjake&oldid=2049452"

Kjo faqe është redaktuar për herë te fundit më 25 tetor 2019, në orën 17:08.

Të gjitha materialet që gjenden në këtë faqe janë të mbrojtura nga [Creative Commons Attribution/Share-Alike License](#);. Shiko [Terms of Use](#) për më shumë informacione.